



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 7.6.2022, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Besian Mustafa, Zoran Mojsilović, Milazim Salijaj, Ekrem Mustafa, Salih Zyba, Isak Shabani, Albena Reshitaj dhe Jetmira Vrenezi.

Munguan: Ganimete Musliu dhe Samra Ilijazi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit.**

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-145 për Parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Komisioni, me 7 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, e miratoi rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-145 për Parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes

Kryetarja, e paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-145 për Parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes dhe tha se projektligji ka 35 nene dhe 4 shtojca dhe ka për qëllim të përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësitë institucionale, caktimin e rregullave për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes nga veprimtaritë e ndryshme industriale në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë për mbrojtjen e mjedisit.

Departamenti i Buxhetit- Ministria e Financave, vlerëson se zbatimi i këtij ligji nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore. Opinioni ligjor i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-se- vlerëson se dispozitat e Projektligjit janë pjesërisht në përputhje me Acquis të BE-së. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit.

Isak Shabani, tha se ky projektligj, si edhe projektligjet e tjera, po vijnë me gabime të shumta drejtëshkrimore dhe përmendi disa në numërim e neneve. *Besian Mustafa*, tha se ato gabime kalojnë edhe përmes stafit politik të minsitrit. *Ekrem Mustafa*, tha se ta kalojmë projektligjin në parim dhe pastaj t' i dërgohet vërejtje ministrisë. *Kryetarja*, tha se për projektligjet që me gabime të shumta po vijnë nga ministria, por së pari ta përcjellim në parim e pastaj i përsërisim vërejtjen për ministrinë.

Ajo i ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se me 4 vota për, asnjë kundër dhe 3 abstenim, Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

Rekomandim:

Të miratohet në parim Projektligji nr.08/L-145 për Parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Kryetarja, tha se raportin me amendamente për këtë përojektligj komisioni më 11.5.2022 e ka proceduar te komisionet e përhershme. Komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar projektligjin me amendamente, *përveç Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim* e kanë shqyrtua projektligjin me amendamente tha kanë rekomanduar se mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Por para se të votohet, tha se duhet të konfirmohen 2 përmirësime në Raport, pasi që janë vërejte në ndërkohë:

Te Amendamenti 2, plotësohet emri i direktivës se tretë, si në vijim: “Ky ligj është në përputhshmëri me Direktivën 2008/50/EC për cilësinë e ajrit mjedisor; Direktivën 2004/107/EC për arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin mjedisor dhe Direktivën 2016/2284/EC për tavanet e emisioneve kombëtare për disa ndotës atmosferikë, e cila ndryshon Direktivën 2003/35/EC dhe shfuqizon Direktivën 2001/81/EC.”

Dhe te neni 39, nënparagrafi 3.1, i projektligjit në fund të fjalisë, fjala “**neni**” zëvendësohet me “**ligji**”.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja ftoi për votim dhe konstatoi se me 8 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Raporti me rekomandime për Projektligjin nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e ajrit nga ndotja, procedohet në seancë plenare për lexim të dytë

6. Të ndryshme.

Salih Zyba, pyeti nëse ka ardhur në komision ndonjë kërkesë, pastaj propozoi që të bëhet një takim me MBPZHR, në lidhje skemën e re të pagesave dhe me AUV.

Besian Mustafa, pyeti rreth kërkesës për takim të shoqatave të verëtarëve dhe vreshtarëve të Rahovecit. Gjithashtu u pajtua që të ftohet ministri i MBPZHR-së në bashkëbisedim në komision në lidhje me mbarëvajtjen e procesit të aplikimit për pagesa direkte, ndërsa edhe vizita në AUV tha se është e nevojshme.

Kryetarja, tha se të gjitha kërkesat që kanë ardhë në komision janë shqyrtuar, për takimin me shoqatën e verëtarëve dhe vreshtarëve, në mbledhjen e kaluar është diskutu për këtë dhe do të bëhet një agjendë për vizitë të këto shoqata dhe të fermerët e tjerë. Për punëtorinë tërëditore për

projektligjet, që do të mbahet më 13 qershor 2022 te restaurant “pylli i arinjëve” te Liqeni i Badovcit, kryetarja kërkoi nga deputetet që ta rezervojnë këtë ditë për të marrë pjesë në punëtori. Gjithashtu u diskutua edhe për gjendjen e projektligjeve në grupe punuese dhe u kërkua që të përshpejtohet puna për procedimin e këtyre projektligjeve.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti: *Stafi mbështetës i Komisionit*

Fitore Pacolli-Dalipi,

Kryetare e Komisionit